



VENDIM

Nr. 06 Datë 30.01.2014

MBI

FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË KURUM INTERNATIONAL SH.A, PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË HEC “ULËZ”-“SHKOPET”, “BISTRICA 1” DHE BISTRICA 2” NË KUADËR TË E MARRËVESHJES ME “IFC”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20, pika 1 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; nenit 8 të Rregullores së Proçedurave e të Transferimit të Aseteve të të Liçensuarve,” si dhe pikave 1.3 dhe 1.6 të liçensës për prodhimin e energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të ERE në mbledhjen e datës 30.01.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti rezulton se janë plotësuar sipas kërkesave ligjore pikat si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2**

Emri dhe adresa e plotë e të liçensuarit:

- **Neni 7, pika 1.3/”a”, “b”**

Përshkrimi i të liçensuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij.

- **Neni 7, pika 1.3/”c”**

“Gjendja financiare në kohën kur paraqitet kërkesa dhe efekti i pritshëm pas transferimit të asetëve.

Janë plotësuar gjithashtu pika 1.3/”d”, “e”, “f”, “g”, “h”, të nenit 7 të Rregullores:

- Pika 1.3/”d” - Përshkrimin e kandidatit përfitues.
- Pika 1.3/”e” -Arsyet dhe shkaku ligjor i barrësimit – motivet.
- Pika 1.3/”f” - Efektet e pritshme të transferimit (dhënies peng/hipotekë) në aktivitetin e të licënsuarit.
- Pika 1.3/”g” - Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licëncuarit dhe në tarifatat e aktivitetit të licënsuar.
- Pika 1.3/”h” - Marrëveshja paraprake.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Kurum International sh.a, për transferimin e aseteve të Hec “Ulëz”-“Shkopet”, “Bistrica 1” dhe Bistrica 2” në kuadër të e marrëveshjes me “IFC”.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes se Konsumatorit për njoftimin e shoqërisë Kurum International Sh.a. për Vendimin e Bordit te Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM

Nr. 06 Datë 30.01.2014

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË KURUM INTERNATIONAL SH.A, PËR TRANSFERIMIN E
ASETEVE TË HEC “ULËZ”-“SHKOPET”, “BISTRICA 1” DHE BISTRICA
2” NË KUADËR TË E MARRËVESHJES ME “IFC”**

Anëtarët e Bordit

| | Pro | Kundër |
|----------------------|-------|--------|
| Petrit Ahmeti | _____ | _____ |
| Adriatik Bego | _____ | _____ |
| Entela Shehaj | _____ | _____ |
| Abaz Aliko | _____ | _____ |